



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republica of Kosova



Kuvendi i Komunës
Skupština Hani Elezit
Municipality Assambly
Hani i Elezit

RREGULLORJA E PUNËS E KUVENDIT TË KOMUNËS HANI I ELEZIT

Hani i Elezit Dhjetor 2008

Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në bazë të nenit 12.2 (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe nenit 34 të Statutit të Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 02.04.2009 miratoi ;

RREGULLOREN E PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS HANI I ELEZIT

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore të Punës së Kuvendit të Komunës së Hani i Elezit (në tekstin e mëtejshëm: Rregullore) përcaktohet procedura e punës dhe e vendosjes së Kuvendit të Komunës, realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të natarëve të Kuvendit të Komunës dhe çështje tjera me qëllim të mirëvajtjes së punës të Kuvendit të Komunës.

Neni 2

- 2.1 Puna e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve është publike.
- 2.2 Në raste të parapara me ligj dhe me këtë Rregullore puna publike mundet të përjashtohet.

Neni 3

Kuvendin e Komunës e përfaqëson Kryesuesi i Kuvendit

Definicionet/Përkufizimet

Neni 4

Termet që përdoren për nevojat e kësaj rregullore kanë domethënien si vijon;

“**Shërbim i kuvendit**”, nënkupton shërbimin Professional të përgatitjes së materialeve, vendimeve dhe akteve tjera të kuvendit dhe komiteteve të tij

“**Fjalë jo të matura**”, nënkupton fjalët qoftë të folura ose të shkruara të cilat përdoren në Kuvendin e Komunës ose Komitetet e tij e që janë:

- a) ofenduese, provokuese, apo kërcënuese
- b) sulme apo ofendime personale,
- c) nxit dhunën gjinore
- d) një akuzë e drejtpërdrejtë kundër një anëtari të Kuvendit ose të ekzekutivit të komunës.

“**Çështje e ngutshme**”, nënkupton një çështje që është e ndërlidhur me një emergjencë të vërtet dhe e cila nuk mundë të paraqitet para Kuvendit në mënyrë të rregullt brenda një kohe të arsyeshme.

“Projekt rregullore”, është një propozim për rregullore i cili përmes ekzekutivit të komunës, komiteteve apo komisioneve të veçanta i është prezantuar Kuvendit për debat dhe votim.

“Grup Parlamentar”, nënkupton një grup të përbërë së paku nga dy anëtar të një partie, koalicioni ose iniciative qytetare, nga një numër i caktuar i anëtarëve të Kuvendit të Komunës të cilët e kanë njoftuar kryetarin e komunës se për qëllimet e tyre do të veprojnë si grup parlamentar.

“Javë pune”, nënkupton javën e punës në të cilën Kuvendi mbanë mbledhje të rregullta, përveç javës Kuvendi mbledhet si pasojë e shqyrtimit të çështjeve të ngutshme edhe në ditët jo të punës.

“Ditë pune”, nënkupton një ditë jave nga e hëna deri të premten, përfshirë edhe këto të dyja me përjashtim të festave zyrtare (publike) gjatë javës në të cilat Kuvendi duhet të mbledhet normalisht.

II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 5

5.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës ka të drejta dhe detyrime në Kuvend të caktuara nga Pushteti Qendror me Ligj, Statut dhe më këtë Rregullore.

5.2 Anëtarët e Kuvendit të Komunës kanë të drejta dhe detyra të barabarta për pjesëmarrje të plotë në punimet e Kuvendit, duke vepruar sipas bindjeve dhe me vetëdijen e tyre autonome.

Neni 6

6.1 Anëtari i Kuvendit ka të drejtë dhe detyrim që të merr pjesë në çdo mbledhje të Kuvendit.

6.2 Anëtari i Kuvendit ka të drejtë që të merr pjesë dhe të diskutoj, por pa të drejtë vote në mbledhjet e komiteteve të Kuvendit.

6.3 Anëtari i Kuvendit ka të drejtë dhe detyrim që në Kuvend të kryej funksionin dhe detyrat të cilat ia beson Kuvendi apo Komiteti i tij.

Neni 7

Anëtari i Kuvendit i cili për shkaqe të justifikueshme është i penguar të merr pjesë në mbledhje të Kuvendit apo të Komiteteve të tij apo gjatë punës duhet ta lëshoj mbledhjen, është i obliguar që ta lajmëroj kryesuesin e Kuvendit përkatësisht komitetit.

Neni 8

Anëtari i Kuvendit të Komunës ka të drejtë të:

- a) kërkoj informacione nga kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës apo Kryesuesi i komitetit.
- b) t'i dorëzoj vërejtjet me shkrim të cilat do të i bashkëngjiten procesverbalit.
- c) t'i propozoj kryesuesit të komitetit që të diskutohet ndonjë çështje që është në kompetencë të komitetit.
- d) të kërkoj nga ekzekutivi të dhëna dhe ndihmë të nevojshme administrative të arsyeshme për punën e tij, nëse ai nuk është i kënaqur në përgjigje, ai mundet të ngritë çështjen në Kuvend. Kuvendi i Komunës lidhur me këtë të merr qëndrim përkatës.

Neni 9

- 9.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës ka të drejtë të bëjë pyetje Kryetarit të Komunës, organeve tjera të administratës si dhe organizatave, enteve e institucioneve tjera të cilat kryejnë punë me interes për Komunën, në mbledhjen e Kuvendit gojarisht, kurse ndërmjet dy mbledhjeve me shkrim.
- 9.2 Me rastin e paraqitjes së pyetjes anëtari duhet deklarohet se a dëshiron që në pyetje të merr përgjigje gojarisht ose në formë të shkruar, drejtpërsëdrejti atij, jashtë mbledhjes apo në mbledhje.

Neni 10

Organet nga neni paraprak janë të obliguar që më pyetjet e parashtruara të japin përgjigje në mbledhjen vijuese, nëse kjo nuk është e mundur, përgjigja do t i jepet në mbledhjen e ardhshme.

Neni 11

Pyetjet e parashtruara dhe dhënia e përgjigjes bëhet para vërtetimit të rendit të ditës.

III *PËRDORIMI I GJUHËS*

Neni 12

- 12.1 Anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe trupat e tij gjatë punës së vet do të përdorin gjuhën dhe shkrimin e saj.
- 12.2 Anëtarët e bashkësive kombëtare kanë të drejtë të komunikojnë në gjuhën e tyre amtare në të gjitha organet e komunës dhe më të gjithë nëpunësit civil të komunës.
- 12.3 Të gjithë dokumentet zyrtare të Kuvendit shkruhen në gjuhën shqipe, dhe në përputhje me Ligjin mbi gjuhët zyrtare.

IV
MANDATI I ANËTARVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 13

- 13.1 Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës zgjatë 4 vite, sipas Ligjit mbi zgjedhjet lokale ,
- 13.2 Mandati i çdo anëtari të Kuvendit të Komunës verifikohet nga Komisioni për Verifikimin e Mandateve që themelohet nga Kuvendi i Komunës para nënshkrimit të mandatit nga secili anëtar.
- 13.3 Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn si në vijim:
“Beto hem (ose deklaroj solemnisht) se do ti kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e miya si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.
- 13.4 Anëtarët e Kuvendit të Komunës të cilët nuk e nënshkruajnë betimin ose mandatin në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni brenda një muaji pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve pushojnë së qeni anëtar i Kuvendit.

Humbja e statusit të anëtarit të Kuvendit

Neni 14

- 14.1 Anëtarit të Kuvendit të Komunës mund t’i pushoj mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur në rastet e përcaktuara me Ligj dhe këtë Rregullore.
- 14.2 Mbi pushimin e mandatit të anëtarit të Kuvendit të Komunës njoftohet Komisioni Zgjedhor Komunal me qëllim të plotësimit të vendit të zbrazur.
- 14.3 Anëtarit të Kuvendit të Komunës i pushon mandati në këto raste;
- a) Po qese jep dorëheqje nga anëtarësia në Kuvendin e Komunës .
 - b) Po qese nuk e nënshkruan deklaratën mbi dhënien e betimit në afat brenda një muaji nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve
 - c) Po qese anëtari i Kuvendit është i dënuar me dënim me burg për një periudhë prej 6 e më shumë muaj.
 - d) Po qese anëtari i Kuvendit apo Komitetit nuk merr pjesë për tre muaj pa ndërprerë në mbledhjet e Kuvendit apo Komiteteve pa arsye të miratuara nga Kuvendi.
 - e) Po qese anëtari i Kuvendit emërohet në ndonjë post i cili e përjashton të drejtën e tij për të qenë edhe anëtarë i kuvendit komunal.
 - f) Nëse ai ndërrohet vendbanimin ku është zgjedhur,
 - g) Pushimi i mandatit të anëtarit të Kuvendit të Komunës konstatohet në mbledhjen e parë të Kuvendit të Komunës llogaritur nga dita e marrjes në dijeni për shkaqet e pushimit të mandatit.
 - h) Konstatimi i pushimit të mandatit të anëtarit të Kuvendit bëhet në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Komunës

V
DETYRAT E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 15

- 15.1 Kuvendi i Komunës ka për detyrë:
- a) Miratimin e Statutit të Komunës, miratimin e Rregullores së Punës, Rregulloreve Komunale si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre,
 - b) Aprovimin e Buxhetit dhe planeve për investime,
 - c) Aprovimin e Planit Vjetor të Punës dhe Raportin Vjetor,
 - d) Zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit ,
 - e) Themelimin e Komiteteve të parapara sipas Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës,
 - f) Aprovimin e nivelit të tarifave dhe ngarkesave,
 - g) Kompensimet për anëtarët e zgjedhur,
 - h) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekorimeve dhe titujve të nderit në pajtim me ligjin në fuqi,
 - i) Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike,
 - j) Arritjen e marrëveshjeve ndër komunale dhe komunale,
 - k) Marrja e vendimeve për tu bashkuar me asociacione përfaqësuese të Komunave të Republikës së Kosovës,
 - l) Aprovimi i marrëveshjeve për krijimin e partneritetit të Komunës me Komunitat jashtë territorit të Republikës së Kosovës,
- 15.2 Kuvendi i Komunës kryen edhe detyra tjera të cilat me ligj janë lënë në kompetence të komunës,
- 15.3 Për marrjen e vendimeve Kuvendi i Komunës mund të ia delegoj pushtetin e tij Komitetit të Kuvendit të Komunës apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheq delegimin në çdo kohë,
- 15.4 Kuvendi i Komunës e miraton Statutin e Komunës, përkatësisht ndryshimet dhe plotësimet e tij me dy të tretat e votave të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
- 15.5 Kuvendi i Komunës e miraton Rregulloren mbi procedurën e punës së Kuvendit të Komunës me më shumë se gjysma e anëtarëve prezent që votojnë në mbledhjen e Kuvendit,
- 15.6 Kuvendi i Komunës vendimin për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe vendbanimeve tjera publike e miraton me vota me se paku dy të tretat e anëtarëve të Kuvendit të Komunës,
- 15.7 Të gjitha materialet nga neni 15.1 i përgatisin organet e administratës Komunale për ato çështje,
- 15.8 Organet e administratës janë të obliguara që materialet nga neni 15.6 të përgatisin në kopje të mjaftueshme për anëtarët e Kuvendit të Komunës,
- 15.9 Materialet nga neni 15.6 për të cilat nuk është formuar ndonjë komision i veçantë i Kuvendit para se të dalin për aprovim në Kuvendin e Komunës i shqyrton Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës,
- 15.10 Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë shqyrtimit të materialeve nga neni 15.6 mund të vendosë që materiali i prezantuar t'i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim apo që materiali t'i kthehet përpiluesit me qëllim të

- ndryshimit apo plotësimit për çështjet të cilat konsideron se duhet ndryshuar apo plotësuar,
- 15.11 Votimi në Kuvend bëhet me vota të hapura po qëse për ndonjë çështje të veçantë nuk është caktuar votim i fshehur me këtë Rregullore apo me ligj.

VI

MBLEDHJET E KUVENDI TË KOMUNËS

MBLEDHJA INAGURUESE

Neni 16

- 16.1 Kuvendi i Komunës duhet të mbajë mbledhjen e parë konstituive (inauguruese) brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e certifikimit të rezultateve zgjedhore,
- 16.2 Mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës e thërret Kryetari i Komunës aty ku është zgjedhur.
- 16.3 Nëse Kryetari nuk është zgjedhur apo nuk e thërret mbledhjen inauguruese brenda afatit prej 15 ditësh, atëherë atë mund t'a thërret anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit Komunës, brenda 15 ditësh nga dita kur Kryetari është dashur ta thirr mbledhjen inauguruese.
- 16.4 Mbledhjen e parë të Kuvendit të Komunës të posa zgjedhur , e kryeson dhe me të udhëheq, deri në zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit dhe dhënies së deklaratës solemne, anëtari më i vjetër i Kuvendit të posa zgjedhur.

Neni 17

Kuvendi i Komunës me shumicën e votave të anëtarëve prezent me votim të hapur merr vendim për vërtetimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit.

ZGJEDHJA E KRYESUSIT TË KUVENDIT

Neni 18

- 18.1 Pas vërtetimit të mandatit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës, anëtarët e posa zgjedhur do të japin deklaratën solemne.
- 18.2 Kryesuesi i mbledhjes e lexon kurse anëtarët tjerë e përsërisin leximin e deklaratës solemne, secili kopjen e vet dhe pas leximit secili anëtarë, personalisht e nënshkruan teksti i betimit sipas nenit 13.3 të kësaj Rregullore .
- 18.3 Pas dhënies së betimit nga anëtarët e Kuvendit Kryesuesi i Kuvendit thërret Kryetarin e Komunës për dhënien e betimit, teksti i betimit është si në vijim:
“Betohe (ose deklaroj solemnisht) që do ti kryej detyrat e mia dhe do ti ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Kaçanikut me nderë, besnikëri, në mënyrë ta pa anshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë”.

Neni 19

- 19.1 Pas dhënies se deklaratës solemne Kuvendi zgjedhë Kryesuesin e Kuvendit
- 19.2 Kryesuesi i Kuvendit zgjedhet nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës me mandatin e njëjtë sikurse edhe anëtarët e Kuvendit.
- 19.3 Votimi për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit është i fshehtë.
- 19.4 Për t'u zgjedhur në votimin e parë kandidati duhet të marrë më shumë se gjysma e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.
- 19.5 Në raste kur në votimin e parë asnjë prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numër më të madh të votave shkojnë në votimet e radhës. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur do të zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Neni 20

Procedurën për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit e zbaton komisioni zgjedhor i përbërë prej tre anëtarëve nga radhët e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 21

- 21.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kryeson Kuvendin e Komunës dhe nënshkruan të gjitha Rregulloret dhe aktet tjera që nxjerr Kuvendi i Komunës
- 21.2 Kryesuesi i Kuvendit kryeson dhe udhëheq Komitetin për Politik dhe Financa,
- 21.3 Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës përcakton rendin e punës për Kuvendin e Komunës dhe për Komitetin për Politik dhe Financa ,
- 21.4 Kryesuesi i Kuvendit i kryen detyrat e tij në pajtim me LVL, Statutin dhe këtë Rregullore.

Neni 22

- 22.1 Kryesuesi i Kuvendit mund të shkarkohet nga detyra vetëm në rast se nuk janë përmbushur si duhet kërkesat e përcaktuara me Ligj, Statut dhe këtë Rregullore,
- 22.2 Kryesuesi mund të shkarkohet vetëm me votat e më tepër se 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.
- 22.3 Votimi për shkarkimin e Kryesuesit bëhet me vota të fshehta,
- 22.4 Nëse vendi i Kryesuesit lirohet, Kuvendi i Komunës zgjedh Kryesuesin e ri jo më vonë se tridhjetë ditë pas shpalljes së vendit të lirë,
- 22.5 Procedura për zgjedhjen e Kryesuesit të ri është e njëjtë sikur për zgjedhjen e Kryesuesit.

VII

MBLEDHJET TJERA TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Konvokimi i mbledhjes së Kuvendit

Neni 23

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës i thërret dhe me ta udhëheq Kryesuesi i Kuvendit .

Neni 24

- 24.1 Kuvendi i Komunës duhet t' i mbajë se paku dhjetë mbledhje në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.
- 24.2 Kuvendi i Komunës mund të mblidhet edhe sipas nevojës.

Neni 25

Kuvendi i Komunës dhe Komitetet e tij mund të mbajnë mbledhje po qese në mbledhje marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve më të drejtë vote.

Neni 26

- 26.1 Kuvendi i Komunës mund të thirret me iniciativën e një të tretës të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të zgjedhur.
- 26.2 Kuvendi i Komunës mund të thirret edhe me iniciativën e Komitetit të tij.

Neni 27

- 27.1 Po qese për shkaqe objektive Kryesuesi është i penguar në udhëheqjen e mbledhjes, Kuvendi i Komunës me shumicë votash të anëtarëve prezent zgjedhë Kryesuesin e mbledhjes. Deri në zgjedhjen e Kryesuesit mbledhjen e udhëheqë anëtari më i vjetër i Kuvendit.
- 27.2 Kryesuesi i mbledhjes nga neni 27.1 kryeson dhe udhëheq vetëm në atë mbledhje në të cilën është zgjedhur që të kryesoj.

Neni 28

- 28.1 Anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet të njoftohen se paku shtatë ditë pune para mbledhjes me ditën, orën, vendin e mbajtjes se mbledhjes rendin e ditës së asaj mbledhje dhe materialin e mbledhjes përfshirë edhe procesverbalin e mbledhjes nga mbledhja e kaluar.
- 28.2 Në rastet urgjente, njoftimi nga neni 26.1 duhet të bëhet se paku tri ditë pune më herët se dita e mbajtjes së mbledhjes.
- 28.3 Pas njoftimit individual për secilin anëtarë të Kuvendit në të njëjtën kohë publikohet edhe shpallja publike për kohën e mbajtjes se mbledhjes të Kuvendit,

28.4 Njoftimi nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni duhet t'i dërgohet Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal së bashku me materialin për mbledhje

Neni 29

Nëse në fillim ose gjatë mbajtjes së mbledhjes konstatohet se nuk ekziston forumi i nevojshëm për vendosje, Kryesuesi e përfundon mbledhjen dhe e cakton terminin për mbledhjen tjetër me të njëjtin rend pune për të cilën gjë në formë të shkruar i njofton vetëm ata anëtarë të cilët nuk janë prezent në mbledhje.

Kryesimi i mbledhjes së Kuvendit

Neni 30

- 30.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës i kryeson Kryesuesi i Kuvendit ,
- 30.2 Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe personat tjerë prezent kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutim.
- 30.3 Askush nuk mund të flasë në mbledhjen e Kuvendit para se të kërkoj dhe ta marr fjalën nga Kryesuesi ,
- 30.4 Pjesëmarrësi në diskutim flet para foltores.
- 30.5 Kryesuesi kujdeset që pjesëmarrësin në diskutim askush mos ta pengoj gjatë diskutimit.

Neni 31

- 31.1 Kryesuesi i Kuvendit u jep pjesëmarrësve fjalën sipas radhës së paraqitjes.
- 31.2 Anëtari i cili dëshiron të flasë mbi shkeljen e rregullave të procedurës ose mbi shkeljen e rendit të ditës, Kryesuesi ia jep fjalën posa ta kërkoj.
- 31.3 Kryesuesi ka për detyrë të jep shpjegim në pikëpamje të lëndimit të procedurës , përkatësisht rendit të vërtetuar të ditës.
- 31.4 Nëse anëtari kërkon fjalën për të korigjuar thinjën që sipas mendimit të tij nuk është e saktë dhe e cila ka shkaktuar mos marrëveshje ose ka nxitur nevojën e sqarimit personal, Kryesuesi do të ia jep fjalën.
- 31.5 Fjala e anëtarit nga neni 31.4 me doemos duhet kufizohet me korigjimin personal.
- 31.6 Anëtari i Kuvendit mund të flasë vetëm për çështjen e cila është në rend të ditës.
- 31.7 Po qese diskutuesi largohet nga rendi i ditës, kryesuesi do të ia paraqes vërejtjen.
- 31.8 Po qese diskutuesi edhe pas vërejtjes se dytë nuk i përmbahet rendit të ditës, kryesuesi mund të ia marrë fjalën.
- 31.9 Në mbledhjen e Kuvendit, anëtarët parimisht për çështjen e caktuar flasin vetëm një here.
- 31.10 Për çështjet në diskutim është e lejuar replika. Replika lejohet çdo herë që të kërkohet derisa të sqarohet çështja në diskutim. Replika është e shkurtër.

Neni 32

32.1 Koha për diskutim për çështjet në rend të ditës, nuk zgjat më shumë se 10 minuta për secilin anëtar, në parim nuk është e kufizuar. Ndërsa diskutimi për rendin e ditës nuk zgjat më shumë se 2 minuta.

32.2 Kuvendi, në mbledhje, po qese konstaton se për ndonjë çështje interesimi është i madh për diskutim, mund të vendosë që të kufizoj kohëzgjatjen e diskutimit.

32.3 Vendimi i Kuvendit për kufizimin e kohëzgjatjes së diskutimit nuk mundet të jetë me pak se 5 minuta, përkatësisht 1 minutë replikë.

Neni 33

33.1 Rendi i ditës për mbledhjen e Kuvendit të Komunës caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës,

33.2 Anëtari i Kuvendit të Komunës mundë të kërkoj shtimin e një pik në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet është çështja urgjente me rëndësi publike,

33.3 Kërkesa e tillë mund të miratohet apo të refuzohet me votën e shumicës

Zhvillimi i mbledhjeve të Kuvendit

Neni 34

34.1 Para fillimit të mbledhjes Kryesuesi i Kuvendit vërteton ekzistimin e kuorunit.

34.2 Pas vërtetimit se ekziston kuorumi, Kryesuesi i e hap mbledhjen e Kuvendit dhe pastaj i pyet anëtarët se a kanë vërejtje në procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

34.3 Për vërejtjet në procesverbal vendoset pa shqyrtim dhe të njëjtat konstatohen në procesverbal.

34.4 Pastaj Kryesuesi i Kuvendit i pyet të pranishmit se a kanë pyetje për të parashtruar në mbledhje dhe ato që kanë arritur më parë jepen përgjigje aty për aty konstatohet se përgjigjet do të jepen në mbledhjen e ardhshme.

Neni 35

35.1 Kryesuesi pastaj cakton rendin e ditës.

35.2 Pas vërtetimit të rendit të ditës kalohet në shqyrtimin veç e veç të çështjeve të caktuara.

35.3 Debati për pikat e rendit të ditës do të bëhet si vijon:

a) Propozuesi i projekt aktit apo i autorizuari i tij do të flas i pari,

b) në rast se propozues nuk është anëtar i ekzekutivit atëherë anëtari i ekzekutivit do të flas i dyti,

c) Kryetari komitetit përkatës do të ketë të drejtën e radhës,

d) Kryetarët e grupeve parlamentare apo anëtarët e kuvendit do të kenë të drejtën e fjalës pasi të kenë folur përfaqësuesit sipas pikave a,b dhe c,

e) Në fund të debatit propozuesi i projekt aktit të përgjithshëm ose i ndonjë propozimi tjetër përmbajtjesor do të ketë të drejtën të përgjigjet dhe pastaj kryesuesi i kuvendit mbyll debatin.

35.4 Shqyrtimi në mbledhje parimisht është unik, por kuvendi mund të vendosë që shqyrtimi të bëhet në parim dhe në veçanti.

35.5 Arsyetimin e çështjeve të propozuara e bënë raportuesi i caktuar për propozues.

35.6 parimisht shqyrtimi bëhet deri sa ka pjesëmarrës të paraqitur për shqyrtim, mirëpo kryesuesi apo secili anëtarë mund të propozoj që shqyrtimi të përfundoj edhe pse ka kandidat të paraqitur për diskutim po qese konstatohet se për atë çështje janë plotësuar kushtet për vendosje, gjë që për të cilën vendosë kuvendi.

Neni 36

36.1. Anëtari i Kuvendit ka të drejtë që për çështjet e caktuara në rend dite të propozoj ndryshime dhe plotësime.

36.2. Ndryshimet dhe plotësimet anëtari i Kuvendit i paraqet në formë amendamenti më së voni 24 orë para mbajtjes së mbledhjes.

36.3. Amendamenti patjetër duhet të jetë i formuluar në formë të shkruar.

36.4. Amendamentet e propozuara konsiderohen pjesë përbërëse e propozimit të caktuar.

36.5. Amendamentin e paraqitur e arsyeton përfaqësuesi i propozuesit.

36.6. I aprovuar është amendamenti i cili ka fituar numër më të madh të votave.

Vendosja në mbledhje

Neni 37

37.1 Me rastin e votimit të çështjes të gjithë anëtarët e kuvendit duke përfshirë edhe kryesuesin kanë vetëm një vote , por në rast të numrit të barabartë të votave për ose kundër kryesuesi ka një vote shtesë.

37.2 Dispozitat e nenit 37.1 aplikohen edhe në rastin e vendosjes në komisione , komitete apo trupa tjerë punues të Kuvendit të Komunës.

Neni 38

38.1 Kuvendi i Komunës dhe trupat e tij punues marrin vendime me votim të hapur, po qese për disa çështje nuk është e rregulluar ndryshe në këtë Rregullore apo me Statut të Komunës.

38.2 Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij punues merren thjeshtë me votimin e shumicës së anëtarëve prezent, po qese për disa çështje nuk është e rregulluar ndryshe me këtë Rregullore.

38.3 Abstenimet regjistrohen me qëllim të konstatimit të kuorumit por nuk merren parasysh në rezultatin e votimit.

VIII RREGULLI DHE SJELLJA NË KUVEND

Neni 39

Anëtarët e Kuvendit nuk duhet të ndërpresin fjalën e Kryesuesit të mbledhjes ose të diskutuesve të tjerë, të përdorin gjuhë ofenduese dhe jo adekuate në mbledhje të Kuvendit, të ndërmarrin veprime jo të mira ndaj ndonjë anëtari, të përhapin informacione që cenojnë jetën private të cilit do anëtar, të sillen në mënyrë të pa denjë ose të shkaktojnë rrëmujë në mjediset e Kuvendit të Komunës.

Masat disiplinore

Neni 40

40.1 Masat disiplinore që zbatohen ndaj anëtarëve të Kuvendit janë:

- a) tërheqja e vëmendjes,
- b) vërejtje,
- c) marrje e fjalës,
- d) përjashtim nga seanca e Kuvendit

40.2 Masat disiplinore që zbatohen ndaj anëtarëve të Kuvendit, zbatohen edhe ndaj anëtarëve të Komiteteve dhe Komisioneve

Neni 41

41.1 Kur anëtari i Kuvendit thotë fjalë të pahijshme, pengon me sjelljen e tij zhvillimin e mbledhjes së Kuvendit ose cenon rregullin e saj, i tërhiqet vëmendja nga Kryesuesi i mbledhjes së Kuvendit,

41.2 Në rast se anëtari i Kuvendit ndaj të cilit është zbatuar masa disiplinore sipas paragrafit 41.1 të këtij neni, kërkon të jap shpjegime për veprimet e tij, fjala i jepet në fund të mbledhjes së asaj dite, por jo më shumë se 2 minuta,

41.3 Kur anëtari i Kuvendit e përsërit shkeljen në të njëjtën mbledhje ose cenon seriozisht rendin në mbledhje nga Kryesuesi i Kuvendit i jepet vërejtja. Vërejtja regjistrohet në procesverbalin e mbledhjes dhe bëhet publike,

41.4 Nëse anëtari i Kuvendit pas shqiptimit të vërejtjes vazhdon me sjelljet e tija apo fjalim që nuk është në përputhje me rendin e ditës do ti merret fjala.

41.5 Kur anëtari i Kuvendit përdor fjalë fyese ose cenon personalitetin e Kryesuesit apo vazhdon të kryej shkelje pasi më parë në të njëjtën mbledhje i janë shqiptuar masat disiplinore sipas këtij neni me urdhër të kryesuesit të Kuvendit përjashtohet nga mbledhja e Kuvendit për atë ditë. Nëse anëtari i Kuvendit i shqiptohet kjo masë nuk e lëshon sallën Kryesuesi i Kuvendit ndërpret mbledhjen dhe ndërmerr masat ligjore për largimin e tij.

41.6 Masa disiplinore e përjashtimit nga mbledhja e Kuvendit dhe Komitetit shoqërohet me sanksione financiare të barabarta me një pjesëmarrje në mbledhje të Kuvendit, përkatësisht komitetit.

Procesverbali

Neni 42

- 42.1 Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij punuese duhet të mbahet procesverbali.
- 42.2 Procesverbali duhet të përmbajë ditën e mbajtjes, kohën , emrat e anëtarëve prezent dhe të ftuar, emrat e anëtarëve që mungojnë dhe shkaqet e mungesës, rendin e vërtetuar, esencën e diskutimit, rezultatin numerik të votimit, çfarë ka dhënë çdonjëri, propozimet e miratuara apo të refuzuara si dhe vendimet e marra për secilën çështje veç e veç.
- 42.3 Nëse Kuvendi vendosë në procesverbal shënohet vota e secilit anëtarë sipas thirrjes se emrit nga regjistri.
- 42.4 Procesverbalin duhet ta mbajë personi i cili është i autorizon nga shërbimi i kuvendit .
- 42.5 Procesverbali duhet të nënshkruhet nga procesmbajtësi dhe kryesuesi i mbledhjes.
- 42.6 Procesverbali duhet të aprovohet në mbledhjen e ardhshme.
- 42.7 Çdo kush ka të drejtë ta shikoj procesverbalin dhe ta marrë nga një kopje.
- 42.8 Pjesë përbërëse e procesverbalit janë tekstet e materialeve të cilat u janë dërguar Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- 42.9 Mbajtjen dhe ruajtjen e procesverbaleve dhe materialeve shtesë për secilën mbledhje veç e veç e siguron kryetari i komunës
- 42.10 Procesverbali nga mbledhja e kuvendit mbahet në formë të shkruar, me anë të stenogramit apo nëpërmjet audio ose video-incizimit.
- 42.11 Materialet e Kuvendit të Komunës kanë vlerë të përhershme prandaj duhet të ruhen.

IX

MBLEDHJA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 43

- 43.1 Kuvendi i Komunës mund të mbajë mbledhje solemne.
- 43.2 Mbledhja solemne e Kuvendit të Komunës mbahet për të shënuar ndonjë ngjarje më rendësi të posaçme.
- 43.3 Në mbledhjen solemne ftohen përfaqësuesit e subjekteve politike, përfaqësues të organizatave punuese , enteve e institucioneve, qytetarë dhe mysafirë tjerë.
- 43.4 Në mbledhje solemne miratohen vendime mbi vëllazërimin e Komunës me Komuna apo qytete tjera, dhënia e titullit qytetar nderi i komunës ndonjë personaliteti, emërimi i ndonjë organizate, enti apo institucioni si dhe shesheve të qytetit me emrin e ndonjë personaliteti të shquar.

X *KONFLIKTI I INTERESAVE*

Neni 44

- 44.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës apo anëtari i komitetit nuk mundë të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material,
- 44.2 Çdo anëtar duhet ti shfaq të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilat është prezent, çdo anëtar mundë të ofroj informacione për interesa e anëtarit tjetër,
- 44.3 Para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit duhet ti regjistrojnë deklarata të plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë Kryetari i Komunës. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin,
- 44.4 Konfliktet e interesit i zgjidhë Kuvendi i Komunës sipas procedurës së caktuar me Statut dhe me këtë Rregullore.
- 44.5 Të gjithë punëtorët e shërbimit civil të administratës i paraqesin me shkrim të gjitha konfliktet e interesit të cilat i ruan udhëheqësi i personelit.
- 44.6 Në rast të konfliktit të interesave zyrtari përjashtohet nga ai rast dhe zëvendësohet me zyrtar tjetër i cili vendosë vetëm për atë rast konkret.

XI *KOMITETET E PËRHERSHME DHE KOMITETET KONSULTATIVE*

Neni 45

- 45.1 Kuvendi i Komunës formon komitete e përhershme , Komitetet Konsultative dhe komitete tjera sipas nevojës,
- 45.2 Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politik dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitetet të përhershme.
- 45.3 Komitete e përhershme reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës.
- 45.4 Mandati i komiteve të përhershëm, zgjat aq sa zgjatë mandate i Kuvendit Komunës.
- 45.5 Kuvendi i Komunës mund të formoj në çdo kohë që paraqitet nevoja komitete, komisione apo grupe tjera punuese ad hok , që u caktohen detyrat dhe afatet e kryerjes se tyre.

KOMITETI PËR POLITIK E FINANCA

Neni 46

46.1 Komiteti për Politik dhe Financa Kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin partiak të kuvendit dhe përfaqësimin gjinor,

46.2 Komiteti për Politik dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën buxhetore vjetore dhe afatmesme,

46.3 Është përgjegjës për shqyrtimin e Planit Vjetor të Prokurimit, Rregulloren Vjetore për Tatimet, Tarifat, Ngarkesat, dhe Pagesat, Planin Vjetor të Punës për Auditivin e Brendshëm,

46.4 Shqyrton Buxhetin Vjetor, afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë viti fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

KOMITETI PËR KOMUNITETE

Neni 47

47.1 Komiteti për Komunitete në përbërjen e vet shumicën e thjeshtë përfshin anëtarët e Kuvendit Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësues të komuniteteve

47.2 Komiteti për Komunitete është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim, dhe shqyrtimin e praktikave dhe aktiviteteve për tu siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht dhe i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e nevojave të komuniteteve.

Neni 48.

Komitetet konsultative dhe komitetet tjera që formon Kuvendi i Komunës obligohen që të hartoj rregulloret e tyre të punës, gjegjësisht Kuvendi i Komunës me vendim i përcakton detyrat e komiteteve ad hok.

XII *PUBLICITETI*

Neni 49

49.1 Mbledhjet e Kuvendit janë publike, përveç në rastet kur Kuvendi vendos ndryshe, ato transmetohen në pajtim me aranzhimet për transparencën të Komunës.

49.2 Kuvendi i Komunës të gjitha aktet e veta për të cilat është e nevojshme të njoftohen qytetarët i bën publike, në tabelën e shpalljeve para miratimit të tyre në Kuvend.

49.3 Regjistrimet mbahen për çdo mbledhje plenare dhe çdo diskutim regjistrohet në gjuhën në të cilën është bërë. Regjistrimet sipas këtij paragrafi ruhen në dosjen e arkivit të komunës dhe i vihen në dispozicion publikut sipas ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 50

50.1 Informimi publik bëhet edhe nëpërmes diskutimit publik.

50.2 Kohën e diskutimit publik e cakton kuvendi i komunës po qese me ligj apo akte tjera nuk është përcaktuar koha për ndonjë çështje konkrete.

50.3 Informimi publik mund të bëhet duke organizuar takime me qytetarë mbi çështje konkrete.

Neni 51

Kuvendi i Komunës mund të bëjë informim publik edhe përmes komunikatave zyrtare apo konferencave për shtyp të cilat i organizon sipas nevojës zyrtari për informim.

Neni 52

Kuvendi i Komunës dhe trupat e tij punues janë të obliguar të sigurojnë kushte dhe të iu lejojnë qytetarëve dhe përfaqësuesve të mediave të përcjellin punën e tyre dhe të i shikojnë dokumentet e tyre që i kanë në dispozicion.

Neni 53

Kuvendi i Komunës dhe trupat e tij të punës mund të vendosin që të përjashtojnë apo kufizojnë publicitetin e punës nëse konstatohet se zbatimi i tyre mund të shkaktoj çrregullim publik apo dhunë dhe nëse zbatimi i tyre do të rezultojë në zbulimin e :

- a) informatiave të ofruara nga pushteti qendror për ndonjë çështje të natyrës konfidenciale,
- b) informatave të ndjeshme personale ose komerciale,
- c) informata që kanë të bëjnë me procese aktuale apo të mundshme gjyqësore, si dhe
- d) çështjeve tjera të cilat me ligj është kufizuar informimi publik.

XIII **BASHKËPUNIMI**

Neni 54

54.1 Kuvendi i Komunës bashkëpunon në mënyrë të barabartë me të gjitha lagjet, vendbanimet dhe fshatrat në territorin e komunës.

54.2 Kuvendi i Komunës është i detyruar të merr në shqyrtim të gjitha nevojat e banorëve të komunës.

54.3 Kuvendi i Komunës në bazë të nevojave të parashtruara nga ana e banorëve bënë rangimin e përmbushjes së nevojave sipas prioritetit dhe në varshmëri me mundësitë materiale.

54.4 Për përmbushjen e nevojave të banorëve të lagjeve, vendbanimeve dhe fshatrave Kuvendi i Komunës siguron fonde përkatëse.

54.5 Iniciativa e ngritur nga ana e banorëve për përmbushjen e nevojave të veta duhet të jetë e bazuar në ligj.

54.6 Nëse Kuvendi i Komunës refuzon përmbushjen e nevojave të banorëve ata mund të kërkojnë pëlqim nga pushteti qendror për përmbushjen e nevojave të veta.

XIV

PROGRAMI I PUNËS DHE RAPORTI VJETOR

Program i Punës

Neni 55

55.1 Kuvendi i Komunës, organet dhe trupat e tij punuese për realizimin e detyrave nga fushë veprimtaria e vet nxjerrin programet e tyre të punës.

55.2 Me Programin e punës vërtetohet përmbajtja themelore e detyrave, mënyra dhe afati i zbatimit të tyre si dhe format e bashkëpunimit me subjektet në varësi.

55.3 Programi i Punës së Kuvendit të Komunës bazohet në kompetencat e veta dhe programet e organeve tjera të administratës.

55.4 Kuvendi i Komunës vërteton programin e vet të punës dhe programet e organeve tjera të administratës.

55.5 Programi i punës së Kuvendit të Komunës, trupave të tij punuese dhe organeve të administratës hartohet për një vit kalendarik.

Raporti vjetor

Neni 56

56.1 Kuvendi i Komunës publikon raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti kalendarik.

56.2 Raporti duhet përmbajë pikësynimet e komunës në lidhje me realizimin e detyrave nga fushë veprimtaria e vet dhe nivelin e realizimit të tyre.

56.3 Raporti duhet të përmbajë sqarimin e mënyrës financiare veç e veç të atyre aktiviteteve dhe të tregojë gjendjen financiare të komunës në fund të vitit kalendarik, deklaratat mbi kontrollet financiare, veprimtaritë e ndërmarrjeve komunale, përkrahjen e dhënë organizatave jofitimprurëse si dhe punë tjera në lidhje me lagjet, vendbanimet dhe fshatrat.

56.4 Raporti Vjetor i prezantohet Kuvendit të Komunës më së voni deri në maj të vitit vijues.

Neni 57

57.1. Trupat tjerë të Kuvendit, organet e administratës, entet dhe institucionet që kryejnë punë me interes për komunën po ashtu publikojnë raportin e tyre të punës.

57.2. Raporti duhet përmbajë të gjitha të dhënat e parapara në nenin 56.2 dhe 56.3 si dhe specifikat tjera të organit që raporton varësisht nga fushë veprimtaria e tij dhe duhet të i dorëzohet Kuvendit për miratim me së voni deri me 30 mars të vitit vijues.

XV

AKTET TJERA TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 58

58.1. Kuvendi i Komunës përveç akteve të përcaktuara me Statut e Ligj, sipas kësaj Rregullore gjatë punës së vet, varësisht nga çështja e cila shqyrtohet, mund të bien vendime, urdhëresa, udhëzime, aktvendime , konkluzione dhe rekomandime.

58.2. Kuvendi i komunës miraton të gjitha aktet e organeve tjera të cilat me ligj i janë lënë në kompetence që të i miratoj Kuvendi i Komunës.

XVI

SHËRBIMI PROFESIONAL I KUVENDIT

Neni 59

59.1 Për kryerjen e punëve profesionale të Kuvendit të Komunës me interes për komunën, trupat punues të Kuvendit të Komunës, ekzekutivin e Komunës dhe organeve tjera të administratës , organizohet shërbimi profesional i Kuvendit.

59.2 Shërbimi profesional i Kuvendit të Komunës kryen punë rreth përgatitjes dhe organizimit të mbledhjeve, siguron mendimin profesional, financiar apo ligjor të çështjeve për shqyrtim dhe vendosje, përgatit projektet e programeve të punës të Kuvendit, siguron materialin dokumentues, u ofron ndihmë profesionale anëtarëve të Kuvendit të Komunës si dhe punë të tjera të përcaktuara me Vendimin mbi Organizimin e Punës së shërbimit profesional të Kuvendit.

59.3 Shërbimi profesional i Kuvendit organizohet dhe ushtron fushë veprimtarinë e vet si shërbim unik i Kuvendit.

59.4 Me punën e shërbimit drejtpërsëdrejti udhëheq dhe punën e tij e mbikëqyrë Kryetari i Komunës

Ndryshimi i Rregullores së Punës të Kuvendit

Neni 60

- 60.1 Kryesuesi i Kuvendit e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e Punës dhe në bazë të nevojës mundë t'i propozoj Kuvendit ndryshime të cilat mendon se janë të nevojshme.
- 60.2 Propozimin për ndryshimin e Rregullores së Punës së Kuvendit mund t'a inicioj çdo grup parlamentar, anëtar të Kuvendit të mbështetur nga së paku 1/3 e anëtareve të Kuvendit të Komunës.
- 60.3 Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së Punës e merr Kuvendi me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit.

Dispozitat Përfundimtare

Neni 61

Kjo Rregullore e Punës së Kuvendit hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit të saj nga Kryesuesi i Kuvendit.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushojnë të vlejné dispozitat e Rregullores paraprake të Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit.

Neni 62

Interpretimi autentik i kësaj Rregullore bëhet nga Kuvendi i Komunës.

Rregullorja Nr.01.17.2009
Hani i Elezit më 02.04.2009

Kryesuesi i Kuvendit

Shaban Qupi